



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS



Kuvendi i Komunës

Nr.02/166

Datë: 24.05.2018

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së V-të ( pestë) të rregulltë të Kuvendit Komunal të Malishevës

**RENDI I DITËS**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/439 datë:22.03.2018 dhe marrja e vendimit për procedurë të mëtejme për dhënien në shfrytëzim të Pishinës publike në fshatin Banjë, KK-Malishevë.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/525 datë:12.04.2018 dhe marrja e vendimit për procedurë të mëtejme për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër, të hapësirave publike për vendosjen e reklamave në qytezën e Malishevës.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/297 datë: 23.04.2018 dhe marrja e vendimit në lidhje me miratimin e bashkëpunimit ndërkomunal në fushën e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/594 datë:20.04.2018 për shqyrtim në parim të Draft-Planit të Integritetit të Komunës së Malishevës për vitet 2018-2020.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/298 datë: 23.04.2018 për shqyrtim dhe marrje të vendimit në lidhje me miratimin e draft-dokumentit, Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Malishevës për vitin 2018.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/404 datë: 13.03.2018, e parashtruar nga zj.Servete Krasniqi nga Malisheva, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (e përsëritur)
8. Shqyrtimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2017 (e perseritur).
9. Shqyrtimi i Raportit vjetor Janar-Dhjetor 2017, i Qendrës për Punë Sociale (e perseritur).
10. Shqyrtimi i Planit të Punës për vitin 2018 i Qendrës për Punë Sociale ( e perseritur).
11. Shqyrtimi i Planit të Zyrës së Prokurimit Publik për vitin 2018 (e përsëritur).
12. Emërimi i anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (e përsëritur).

13. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/481 datë:30.03.2018 për inicimin e procedurave për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për z. Enver Kastrati nga fshati Maxharrë.
14. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/97 datë:11.04.2018 e parashtruar nga shefi i grupit të anëtarëve të Kuvendit të Lëvizjes VETËVENDOSJE, për rikthimin e të drejtës së parkimit të makinave përgjatë rrugës Rilindja Kombëtare (Ibrahim Mazreku).
15. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/79 datë:05.04.2018, e parashtruar nga Maliq Paqarizi nga fshati Dragobil, për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
16. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/69 datë:03.04.2018, e parashtruar nga Adem Hoti nga Malisheva, për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
17. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/110 datë: 18.04.2018 e parashtruar nga Zenun Krasniqi nga fshati Astrazup, për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
18. Debat në lidhje me kërkesën nr.02/78 datë: 05.04.2018 të parashtruar nga Shpejtim Sertolli nga fshati Bellanicë.
19. Paraqitja e raportit nga kryetari i Komunës për punësimet në Komunën e Malishevës me kontratë në vepër, sipas kërkesës së parashtruar nga Grupi i këshilltarëve të PDK-së.
20. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.11/394 datë:20.04.2018, e parashtruar nga DKAE në Malishevë për të përkrahur financiarisht pagesën e tri pagave përcjellëse për personelin arsimor të cilët janë pensionuar në vitin 2015,2016,2017 dhe 2018, si dhe kërkesa nr.01/596 datë:20.04.2018, e parashtruar nga Menaxheri i personelit në KK.Malishevë, për të përkrahur financiarisht pagesën e tri pagave përcjellëse për zyrtaret e administratës të cilët janë pensionuar në vitin 2014 dhe 2018.
21. Debat publik mbi qeshtjet e barazisë gjinore ne Institucionet publike të Komunës së Malishevës.
22. Emërimi i anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve (e përsëritur).
23. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/211 datë: 12.02.2018, për marrjen e vendimit për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e Sallës së Sporteve në fshatin Drenoc (e përsëritur).
24. Të ndryshme.

Mbledhja mbahet me datë 30.04.2018 dhe filloi në ora 10:20. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 25 asambleistë, Kryetari i Komunës, Nënkryetari, drejtorë të drejtorive, OSBE dhe media.

**Rrahim Morina:** Përshëndetje për Kryetarin, drejtorët dhe për ju të pranishëm. Të pranishëm janë 25 asambleistë dhe fillojmë me mbledhjen. Sipas Rregullores së Punës së Kuvendit, e hapi debatin jashtë rendit të ditës. Ju lus që të respektoni kohën që keni 30 min.

**Sadije Krasniqi:** Përshëndetje Kryetar, drejtorë dhe ju anëtarë të Kuvendit! Gjatë punës sonë këtu do të përmballemi me sfida të ndryshme dhe vendim që shpeshherë nuk janë të lehta. Por, pavarësisht këtyre sfidave dhe vendimeve të rëndësishme që ne do të marrim dhe në fund do t'na mbetet vetëm intergreti dhe ndërgjegjia jonë. Në qoftë se arrijmë që të kemi një ndërgjegjie të

pastër, atëherë mund të jemi të qetë dhe ballëhapur para qytetarëve tanë dhe pasaj mund të themi që kemi kontibuar për shoqërinë tonë. Prandaj uroj që qytetarët tanë pas shumë vitesh t'na falemnderojnë për punët dhe vendimet e mira që do të marrim këtu. Falemnderit!

**Valon Krasniqi:** Përshendetje për Kryetarin, Kryesuesin e Kuvendit, anëtarët e Kuvendit dhe ju të pranishëm! Kryetari i Komunës z. Begaj dhe Ministri i Infrastrukturës Pal Lekaj me dt. 24.04.2018 organizuan një spektakël medial kinëse po nënshkruajnë një memorandum të mirëkuptimit për financimin e projekteve infrastrukturore për Malishevën, për rrugër siç janë: lagjia "Hoti" në Malishevë, fshatrat Gullubovc, Stapanicë, lagjia "Binishi" në Banjë, Kërvasari dhe Carrallukë. Pastaj në Llapçevë rrugën "Ujëvara e Mirushës", Mleqan, Pllloqicë dhe Sferkë. Andaj për hir të opinionit ju informoj që këto projekte janë financuar nga qeveria Mustafa dhe janë votuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Këtë spektakël medial nuk mundeni t'ju shitni qytetarëve të Malishevës dhe as t'ju "qitni hi syve".

Zoti Begaj, po ju rikujtoj që këto projekte janë inicuar nga Kryesia e Degës së LDK-së në Malishevë dhe janë financuar dhe votuar nga Qeveria Mustafa. Nëse keni harruar Kryetar, ju patët nënshkruar momerandum bashkëpunimi me ministrin e Infrastrukturës me z. Lutfi Zharku. Andaj nuk është mirë Kryetar të veproni në këtë mënyrë. Është mirë që të jeni të sinqertë para qytetarëve dhe mësohuni që ta çmoni dhe ta vlerësoni edhe punën e të tjerëve.

**Alban Mazreku:** Përshëndetje për të gjithë! Për diskutimin jashtë rendit të ditës dua ta ngrisë çështjen e ndriçimit publik në qytetin e Malishevës.

I nderuari Kryetar, ende pa u bërë një vit, ju keni intervenuar në rregullimin e ndriçimit publik, ndërsa në rrugën: "Gjergj Kastrioti-Skenderbeu" ndriçimi publik është jashtë funksionit. Gjithaashtu edhe në rrugën: "Rilindja Kombëtare", kah shtëpia e shëndetit dhe andej kah lagjia e "Gurit" si dhe rruga "Hamdi Berisha" nuk funksion ndriçimi publik.

Kryetar, ata tenderistat që i rregullojnë duhet me pas një lloj sigurie që nëse prishet diçka duhet ta rregullojnë.

I nderuari drejtor, Blerim Thaçi, me datën 23 të muajit të kaluar unë, Alban Krasniqi dhe Kastrioti e kemi ngritur një çështje për shkollën fillore në Malishevë. Në atë shkollë, me të vërtetë është duke u bërë një mizerje. Çdo ditë fëmijët duhet t'i çojmë të mjeku për arsye që ambienti është shumë i ndotur. Pas asaj date që kemi ngritur këtë çështje nuk është reguar asgjë nga ana juaj. Unë jam detyruar që më datë 20.04.2018, e kam bërë një kërkesë dhe ju kam drejtuar Inspektoriatit të Komunës së Malishevës. Ky Inspektoriat janë dal në terren dhe e kanë verifikuar gjendjen në shkollë. Ata kanë lëshuar një procesverbal që unë nuk e kam, edhe pse është dashur ta kem ligjrisht pasi unë kam bërë kërkesën. Në atë procesverbal Inspektoriti ka urhëruar pothuajse të mbyllet shkolla. Por, prap se prap nuk është bërë asgjë në atë drejtim. Kërkoj një përgjigje sot edhe nga Drejtoria e Inspektoriatit edhe nga ajo e Arsimit.

Drejtor i Arsimit në shkollën fillore të Malishevës vijojnë mesimet 4 klasë të gjimnazit. Aty ka konflikt gjeneratash dhe ka shumë ankesa prej prindërve dhe arsimtarëve që ata nxënësa sillen shumë keq me fëmijët e vegjël aty. Kërkoj që të ndërhyni në këtë çështje, sepse e keni atë fuqi.

Kryetar, që nga fillimi i rrugës "Gjergj Kastrioti" si dhe në hyrjen e shtëpisë së shëndetit ka shumë gropa e pothuajse në të gjitha rrugës. Qytetarët ankohen sepse ka shumë dëmtime të veturave.

Gjithaashtu rruga në hyrje të shtëpisë së shëndetit deri te hyrja e shkollës "Ibrahim Mazreku" pothuajse çdo ditë është e bllokuar nga parkimi i makinave aty. Kryetar, ke kompetenca me ligjin

për Vetëqeverisje Lokale që të kontaktoni Komandatin e Policisë që të mos lejohet ai parking sepse po pengohet qarrkullimi.

**Faik Zogaj:** Përshëndetje për të gjithë! Në emër të grupit e shprehi shqetësimin për formimin e komisioneve e sidomos për atë të KPF-së. Kërkoj nga të gjitha grupet që të reflektojnë pozitivisht në këtë çështje. Numri i anëtarëve për të komision duhet të jetë në bazë të përqindjes së asambleistëve që e përfaqësojnë këtë Kuvend. Sigurisht që NISMA i takojnë 3 vende me çfarëdo matetmatike. Gjithashtu në këtë komision barazia gjinore nuk është mirëfill dhe ka ra në kundërshtim me MAPL-në. Në anën tjetër kemi pikë të rendit të ditës që të trajtohet çështja e barazisë gjinore. Kjo është në kundërshtim me atë që ëshë vepruar në këtë Kuvend e po vazhdon të jetë i tillë. Ne kërkojmë që të jeni më transparentë pasi të njëjtën gjë po e kërkon edhe nga ne.

**Kastriot Berisha:** Përshëndetje për të gjithë! Po ndërlidhem më çështjet që ngrit Albani. Kryetar, rruga "Hamdi Berisha" që lidh shtëpinë e shëndetit, gjimazin dhe shkollën fillore "Ibrahim Mazreku" është me të vërtetë e pakalueshme. Aty nuk merren kurrëfarë masash për makinat që parkohen. Gjithashtu aty është edhe një shtyllë elektrike në rrugë. Nuk e di kur do të mbyllen ato gropo që po renovohen në minitransitin. Nëse ja keni dhënë dikujt tenderin për mbylljen e atyre gropave, aty ka shumë gropa që s'janë mbyll e veç e kanë prerë asfaltin, pra gjendja është veç më keq. Rruga Malishevë-Kjevë është më të vërtetë në gjendje të mjerueshme. Në ato gropa ja po dalim e po mbjellim pisha, ja rregulloni së paku sa me bërë të kalueshme.

**Alban Krasniqi:** Kastriot nëse mbjellim pisha aty, bëhet mal i shpeshtë sepse ka shumë gropa. Përveç asaj që ngriti Albani për shkollën "Ibrahim Mazreku", unë po ndërlidhem për një segment tjetër. Gjendja higjeniko-sanitare në atë shkollë vërtetë që nuk është vetëm e mjerushme, por edhe procesi mësimor nuk është që dallon shumë prej saj. Ky është një problem që duhet të trajtohet në mënyrë urgjente. Sa i përketë përgjegjësisë politike aty është dashur të niset nga Kryetari e teposhtë deri të drejtori i shkollës. Çështja për të cilën po flas ka të bëjë me organizimet mbrenda shkollës, duhet të ketë një lloj kontrolli se çka ndodh nëpër shkolla dhe si bëhen ato organizime dhe a janë apo jo të ligjshme. Konkretisht rasti është për "Festën e Abetarës" te nxënësit e klasës së parë. Kam dëgjuar që ju kanë kërkuar prindërve 9.50 € që të paguhen për këtë festë në emër të rrobave apo diçka tjetër. Nëse në këtë moshë fillojmë më paguar këtë shumë, llogariteni sa më i madh fëmiu si nxënës aq më të mdha obligimet. Menoj që organizimet zyrtare siç është "Festa e Abetares", përgjegjësinë duhet më marrë vet drejtorja e Arsimit që t'i mbulojë këto shpenzime. Kjo festë është e ngjashme me ditën e shkollës, tani prindërit a duhet të paguajnë para që nxënësit të përgatiten për ditën e shkollës?! Jo, mendoj që këtë duhet ta kryej shkolla. Për organizime të tilla kërkoj që Drejtorja e Arsimit të nxjerrë një vendim e të rregulloj në mënyrë të detajuar organizimet e tilla e të mos e degradojnë shkollën, sepse as organizimit të Festës të Abeteras, do të shkojnë në një restorant. Askund në vendet e BE-së nuk guxon fëmijët me i çu në restorant. Mos ta degradojmë shkollën deri te parashkollori! Ne e kemi sallën e shollës, shtëpinë e kulturës edhe pse është e dëmtuar e nuk po e shikon askush. Drejtor, merri masat e duhura dhe të mos shkojnë fëmijët nëpër restorante!

**Arbëreshë Krasniqi:** Përshëndetje për të gjithë si dhe për Ahmetin që është atje në fund dhe për bashkëpunimin e mirë që kemi pasur në legjlistarunë e kaluar!

Grupet politike në këtë Kuvend Komunal të mos veprojnë dukur u monitoruar dhe dirixhuan nga të tjerët, po të veprojnë në bazë të logjikës dhe t'i thrrasin mendjes dhe arsyes. Duhet të veprojnë ashtu se si qytetarët e Komunës së Malishevës e dëshirojnë.

Çështja e vërejtjeve dhe kërkesave që i dëgjova këtu e që ishin të arsyeshme. Unë çdo ditë e shoh rrugën Malishevë-Kjevë sepse i bie andej. me të vërtetë është shumë e dëmtuar ajo rrugë. Aty janë disa shënime te gropat që shkruan "votoni NISMA" nga disa veprime të se di kujt. Unë ju them të gjithëve qytetarëve të Malishevës që njeriu që e ka hek Malishevën nga balta, është Kryetari Limaj, dhe mos keni dilema që të gjitha ata rrugë që janë dëmtuar do të rregullohen shumë shpejt.

Rruga Malishevë-Kjevë të gjithë e dimë që është në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës, jo në kuadër të K. së Malishevës. Unë i lutem Kryetarit Begaj që të ketë angazhim shtesë, përveç marrëveshjes së bashkëpunimit me Pal Lekaj, që çështja e kësaj rruge të rregullohet sa më shpejt, biles së paku të rregullohen ato gropa që shkaktojnë dëmtime teknike!

Kryesues, rendi i ditës është shumë i ngarkuar ju lus juve dhe të gjithë grupet politike që të jemi sa më të shkurtër dhe t'i kontribuojmë kësaj seance.

**Rrahim Morina:** Kryetar, koha për debatet jashtë rendit të ditës mbaroi, a do të japësh sqarime?

**Kryetari-Rragip Begaj:** Përshëndetje për të gjithë ju! Mbjajta shënime për disa pyetjet që ju parashtruat këtu.

Valon, nuk kam bërë spektakël me ministrin Pal Lekaj, zgjidhi pak fjalët. Unë kam bërë marrëveshje. Madje Pal Lekaj ka kërkuar nga unë që t'i vazhdojmë ato projekte që i kemi bërë me Lutfi Zharkun dhe asnjë pikë e as presje e tyre nuk ka ndryshuar. Ka qenë e domosdoshme me bërë buxhet shtesë për ato projekte sepse kanë qenë të vitit të kaluar e në disa rrugë punimet kanë filluar dhe do të fillojnë në këtë vit.

Për rrugën Malishevë-Kjevë kemi biseduar edhe me ministrin që këtë rrugë duhet ta kryej Ministria sepse është në përgjegjësi të saj. Është zotuar që do ta renovojë sa më shpejt, e çka bëjnë me të tani nuk e di. Unë kam bërë presion për këtë rrugë sepse e di në çfarë gjendje është. Unë asnjëherë nuk kam premtuar para qytetarëve të mi që do t'i rregulloj të gjitha çështjet në

Komunën e Malishevës mbrenda këtij mandati, sepse një punë kryhet, del tjetra.

Alban, me ndriçimin publik kemi probleme. Më së shumti kemi probleme në këtë çështje prej faktorit njeri. Ka pasur demolime dhe prishje të trafave në mënyrë të egër.

Më vjen keq për gjendjen në shkollën fillore në Malishevë. Kjo shkollë është ndërtuar mbas luftime, ndoshta është neglizhencë e mos mbajtjes siç duhet mbase ka ardhur në këtë gjendje. Më shumë sqarime do të jap Blerimi për këtë çështje.

Në rrugën te gjimnazi sa i përket makinave që parkohen aty, me të vërtetë është keq. Po unë e pata ndaluar parkingun gjta rrugës "Rilindja Kombëtare", ju tani po kërkon me kthye që është jashtë nomrave ligjore. Unë do t'i thrras ekspertat e komunikacionit dhe do jap pëlqimin për ndalimin e parkingut në rrugën e gjimnazit.

Ministrançiti Kastriot është keq! Ne kemi intervenuar që ato gropat të rregullohen dhe ajo rrugë të përmirësohet, do të dal ta shoh se sa është punuar aty, sepse e di që puntë kanë filluar.

Alban, ndoshta ka parregullësi nëpër shkolla, por në krahasim me komunat tjera jemi ma mirë shumë. Sa i përket asaj çështjes për "Festën e Abetares", Blerimi të jep përgjigje sepse unë nuk e di.

Unë i ka sjellë disa kërkesa te ju. Kërkoj që çështjet që janë shumë të rëndësishme siç është rregullimi i shtratit të lumit Mirusha, kërkohet që me i leju procedurat për shpronësim. Pra duhet

të merret vendimi për shpalljen e zonës së interesit për mbrojtjen e lumit. Unë i kam bërë disa elaborate dhe çdo gjë bëhet në mënyrë ligjore. Një gjë po them, kur është interesi im kurrë mos votoni asgjë, por ky projekt është në interes të qytetarëve dhe për të mirën e Malishevës prandaj kërkoj që ta miratoni këtë kërkesë.

Analizoni të gjitha kërkesat që kam sjell para jush, shikojeni anën e mirë për interesin e këtij vendi dhe veproni ashtu siç ju mendoni që është më së miri.

**Rrahim Morina:** Alban, 1 min replikë, të lutem!

**Alban Krasniqi:** Për projektet e dështuara të kësaj qeverisje ju hudhet në vazhdimësi faji qytetarëve. Kjo është një padrejtësi e madhe dhe e turpshme. Nuk e ka fajin për projektet e dobëta qytetari, e kanë kompanitë të cilat filtrojnë me NISMA në këtë rast, me Kryetarin dhe drejtorët e tij. Stadiumi na ka kushtuar 800,000€, e ai stadium nuk e ka as pamjen e stadiumit madje as nuk di si ta quaj. Është e turpshme se në çfarë gjendje është lënë prej nëntorit, 400,000€ janë paraparë. Mos u tallni more me ne, kjo është padurueshme për një njeri normal në këtë vend! Ju po mendoni që me i duru këto punë të këqija, këtë krim e korrupcion, e me u sjell natyrshëm. Unë nuk mund të sillem natyrshëm sepse e di që janë disa dëshmorë atje, e krejt Kosova është e mbjellur me viktime e dëshmorë për këtë vend. Për mos me vjedh, për mos me fëlliq këtë vend!

**Kryetari- Ragip Begaj:** Satdumi është përgjegjësi e Ministrisë sepse ata i kanë bërë investimet. Mos më akuzo me hajni e fjalë të tjera, kurseu nga fjalori.

**Blerim Thaçi:** Përshëndetje për të gjithë! Alban, është e vërtetë që ka defekte në tualetet e shkollës "Ibrahim Mazreku", biles javës që shkoi kemi bërë disa sanime. Sa i përketë asaj që the për inspektoriatin, nuk ka vendim për mbylljen e shkollës. Ka një raport ku kërkohet të intervenohet. Në bazë të kësaj kërkesë kam biseduar edhe me drejtorin e Finacave edhe me Kryetarin për këtë vit e kemi një telashe sepse kemi veç 50,000€ për renovimin e shkollave. Kërkoj nga ju që të ndahen më shumë mjete për renovime sepse nuk është vetëm shkolla "Ibrahim Mazreku" që ka nevojë por kemi edhe disa shkolla të tjera. Ne do sjellim një kërkesë që të ndahen mjete shtesë për këtë çështje. Është një donacion në vlerë 30,000€ e që ne i kemi paraparë që të intervenohet në shkollën fillore "Ibrahim Mazreku". Për klasët e gjimnazit është fakt se mësimet i ndjekin në shkollën fillore deri sa të përfundojë ndërtimi i aneksit të gjimnazit. Kuptohet që është një lloj presioni në kuadër të moshave të nxënësve.

Alban, "Festa e Abetares" është absolutisht proces që duhet të mbahet në kuadër të procesit arsimor, asnjëherë jashtë kornizave që nuk lejohet. Po ju bëjë me dije që asnjë shkollë nuk ka drejtë të kërkojnë mjete për fëmijët, për çfarë do aktiviteti që organizohet në shkolla. Ne nuk kemi marrë asnjë ankesë për çështje të tilla. Ju bëjë thirrje që nëse në donjë shkollë bëhet ndonjë kërkesë e tillë, le të vijë drejtë në Drejtorinë e Arsimit dhe ju garantoj që do të merren masat ndaj atyre që kërkojnë këso mjetësh. Gjithaashtu nuk lejohet nga DKAja që të organizohet asnjë festë jashtë shkollës ose edhe nëpër restorante.

**Rrahim Morina:** Kërkoj falje që materialin ju kemi shpërndarë me një ditë vonesë për shkak të pritjeve deri në kompletimin e dokumenteve. Janë tri kërkesa të Kryetarit që kanë ardhur direkt në Kuvend. Po i lexoj të tria. Kërkesa nr. 01/649 që është propozim për shpalljen në interes

publik të pronave private sipas elaboratit të shpronësimeve dhe këmbim të pronës së palujtshme komunale me pronën e palujtshme në pronësi të personave fizik komform procedurave ligjore të ligjit në fuqi në Republikën e Kosovës. Kërkesa e dytë që është për barjtjen e mjeteve vetanake nga viti fiskal 2016 dhe 2017 në vitin 2018. Kërkesa e tretë e Kryetarit është për iniciimin e procedurave për ndërrim-destinimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore e që është kërkesë e qytetarit fjala është për Sadik Bytyqin nga Malisheva. Këto kërkesa kanë ardhur sot, edhe pse jemi marrur vesh që të gjitha kërkesat të kalojnë nëpër KPF. Tani hapi debat rreth rendit të ditës. Propozojë që të debatohet në nivel shefish sepse sigurisht i keni qëndrimet e juaja.

**Arbëreshë Krasniqi:** Duke e pasur parasysh gjendjen e këtyre letrave në tavolinë shihet qartzi serioziteti i punës në Kuvend. Janë 25 pika të rendit të ditës, me të vertetë është tepër kjo. Ne jemi të thirrur që të japim kontributin aty ku mundemi.

Kryesues i paraqite kërkesat e Kryetarit, gjë për të cilën e falemnderoj Kryetarin për një nismë të tillë, sepse është mëse e nevojshme për qytetarët shpallja e zonës së interesit. Këtu është elaborati i shpronësimit ndoshta është pak vonë që ta kemi të qartë dhe të kuptueshëm ne si asambleistë, por në këtë rast është vetëm si iniciim. Konsideroj që kërkesat e kryetarit në këtë rast duhet të futen në rendin e ditës dhe të trajtohen dhe me votën tonë të vendosim a të kalojnë apo jo.

Kryetari i Komunës bënë kërkesa për Kuvendin Komunal me arsyetimin e vet që qytetarëve t'ju lehtësojë problemet apo mënyrën e jetës së tyre. Mos t'i shohim këto kërkesa si politike. Është mirë që t'i trajtojmë së bashku e pa bërë politkë.

**Alban Mazreku:** Ne PDKja propozojmë që pika e 3-të të shtyhet pasi që kjo pikë nuk ka kaluar në KPF. Njëherit i bëjë thirrje NISMA që t'i dërgojnë përfaqësuesit e tyre në KPF që ky komitet të jetë i pranueshëm për të gjithë.

Pika e 5-të kërkojmë të shtyhet pasi që materiali ju ka shkuar vetëm shefave të grupeve, ndërsa asamblesitët nuk e kanë këtë material.

Pika e 6-të gjithashtu kërkojmë që të shtyhet sepse nuk ka kaluar nëpër KPF.

Pika e 20-të, ne kemi kërkuar në mbledhjen e kaluar një raport për ata të cilët kanë dalur në pension nga DKA-ja, prandaj ne kërkojmë që të shtyhet edhe kjo pikë.

Gjithashtu kërkoj që edhe kërkesat e Kryetarit të shtyhen e të kalojnë nëpër KPF.

Pasi shumë pika janë grumbulluar duke u shtyrë nga mbledhja në mbledhjen tjetër, propozoj që të thirrni një seancë ndaq të rregullt apo si të doni quani Kryesues që të trajtohen këto pika.

**Valon Krasniqi:** Ne LDK-ja e konsiderojmë të arsyeshme që të gjitha pikat e rendit të ditës që nuk kanë kaluar nëpër KPF të shtyhen. E sa i përket kërkesave të Kryetarit ne si grup kërkojmë 5 min pauzë që të konsultohemi së paku ta shfletojmë materialin.

**Alban Krasniqi:** Ne e kemi vendosur një praktikë në KPF dhe e ftojmë NISMA që t'na bashkohet sepse barrën e tyre po vazhdojmë ta bartim ne. Ne nuk lejomë të anashkalojmë ose të bëjmë ndonjë lëshim procedural për çështjet që duhet të diskutohen në Kuvendin Komunal.

Një elaborat me gjitë këto të dhëna i cili do të duhej bile t'i nështruhej një prezantimi këtu se di duket ky projekt. Është dashur që të thirren edhe qytetarët paraprakisht dhe të ketë debat se si mendohet se do të bëhet shpronësimi, ndërsa sot po kërkohet tani për tani të futet në rendin e ditës. A është kjo vlerë evropoiane? A veprojnë kështu asamblesitët e komunave nëpër secilin

vend të Europës? A është kjo ajo që ne po duam ta kemi si praktikë? Nuk e besoj këtë, pa dallim partie këtu. Kjo duhet gjithësesi të shtyhet.

Sot këtu u përmend transparenca, por çfarë transparence kur ky plan me krejt idetë se si mendohet të bëhet ai projekt nuk u është prezantuar qytetarëve. Është dashur t'i bëhet një prezantim dinjetoz nga ekspertët, të tregohet se sa e ndal vërshimin kjo trase e re. Për krejto këto çështje ne është dashur të marrim përgjigje që ne të vendosim a me fut, apo jo në rendin e ditës.

Neve përsi na kanë ardhur pika shtesë prej asaj që kemi diskutuar në KPF. Është e vërtetë që Kryetari mund të sjellë pika, por duhet t'i sjell ato në KPF. KPF-ja është organi që duhet t'i shqyrtojë. Pajtohemi me propozimet e Albanit që ato pika të shtyhen, përveç atij projekti me UNDP sepse atë duhet ta diskutojmë e ta kemi një prezantim parapark sepse është shumë i përgjithshur.

**Rrahim Morina:** Grupi i LDK-së këroi 5 min pushim. Shkojmë në pauzë. Mund të vazhdojmë. Urdhëro LDK-ja e ka fjalën.

**Valon Krasniqi:** Grupi i LDK-së kërkon që të gjitha pikat, po ashtu edhe kërkesat e Kryetarit duhet të kalojnë nëpër KPF e pastaj të diskutohen këtu.

Ne gjithashtu kemi një propozim që kërkojmë të futet në rendin e ditës. Propozimi ynë është që: Shqyrtimi i zbatimit i udhëzimit administrativ nga gjimnazi "Hamdi Berisha" lidhur me ekskurzionin e maturantëve të vitit shkollor 2017/2018.

**Rajmonda Krasniqi:** Shqyrtimi ajo është diçka që është udhëzim prej Ministrisë, por njëkohësisht mund t'ja shtojmë edhe fjalën raportimi i organizimit të procedurave të eskurzionit. Këtë donte të thoshte Valoni.

**Rrahim Morina:** Valoni ka gabuar pak sepse këtu e ka shkruar shqyrtimi i zbatimit të udhëzimit administrativ.

**Arbëreshë Krasniqi:** Alban, të jeni të bindur që më të dy këmbët po e shkelni ligjin. Në KPF keni shkelje ligjore që keni marrur vërejtje nga MAPL-ja.

Faiku e tha për pikën e rendit të diës që ka të bëjë me barazinë gjinore. Edhe këtu po e shkelni ligjin. Nuk e keni plotësuar atë pjesë të komitetit me barazi gjinore. Nëse ju ka dhënë mundësi me këtë gjë që të shkelni ligjin e automatikisht neve, e një pjese të qytetarëve ju lind kjo dilemë. Çka nëse do t'ju jepej mundësia që të keni më shumë fuqi?!

Temat që duhet të trajtohen në Kuvend nga anëtarët e Kuvendit të mos trajtohen këtu e të kalojnë në KPF, unë konsideroj që është gabim. Asamblea dhe 31 anëtarë është më shumë se sa Komiteti. Secila temë që është në dobi të qytetarëve të Malishevës është legjitime që të trajtohet këtu. Nëse të gjitha temat duhet të trajtohen në KPF, atëherë po biem ndesh dhe po i shkelim anëtarët tjerë të Asamblesë të cilët nuk e kanë atë fuqi ligjore që të jenë anëtarë të KPF-së.

E kam thënë disa herë që komiteti duhet të plotësohet patjetër me 3 anëtarë të NISMA dhe kështu do të rrubullakësohet me 7 anëtarë. Ne nuk i frikësohem asaj që edhe në KPF opozita është më shumë edhe në këtë rast. Nëse do të ketë mbivotim atëherë do të ketë edhe në KPF. Atëherë nuk e di se ku e keni këtë problem?!

Çështja tjetër, kërkesa e Kryetarit që ka të bëjë me shtratin e lumit, është më shumë se domosdoshme dhe më shumë se urgjente për qytetarët e K. së Malishevës. Është një projekt i mirëseardhur për qytetarët dhe ne duhet ta trajtojmë seriozisht. Ne jemi ata që e kemi marrur



besimin e tyre dhe ne duhet t'i trajtojmë me seriozitet çështjet që janë në dobi të tyre, por jo edhe në këtë formë. Ne e dimë për vërshimet që kemi pasur Alban, këtu është rreziku që mos të kemi tentativë që t'i anashkalojmë.

Në fund ju lutem që kërkesat e Kryetarit të futen në rendin e ditës e më tutje të trajtohen për gjatë rendit të ditës.

**Alban Krasniqi:** Këtu janë 104 prona e pronarë që prekën me këtë vendim tonin, e këta kërkojnë për 1 orë këtë punë me kry. Pra ky është trajtimi serioz Arbëreshë që përmndët ju. Unë kërkoj që duhet të ketë debat me qytetarët, le ta shohin ata se cilat prona prekën. Duhe kohë që ta analizojmë e pastaj ta trajtojmë këtë material. Kjo ju se si po kërkon, kjo s'ka të bëjë me demokraci. Kjo veç në kohën e mbretit, në fedualizëm i bjen çekiçit the thotë "u kry kjo".

Kush po frikësohet që me i thirrë qytetarët këtu? Kush po i frikësohet asaj që ne me i shfletu dokumentet? Interesi i përgjithëshëm nënkupton edhe diskutimet me qytetarët.

Sa i përketë çështjes së barazisë gjinore që u përmend këtu, Arbrëreshë, kur ta bënë Kryetari barazinë gjinore këtu, në secilin vend rend po e bëjmë ne. Le të hiqet Fatmiri prej Zv. Kryeministrit e le të bëjnë ty, e kështu po vazhdojmë edhe ne. Jo me na shit mend neve këtu për barazi gjinore pjesërisht, e këndeje mbrapa Kryetari qeverinë e ka mbush me burra.

**Alban Mazreku:** Meqenëse kjo është një çështje e rëndësisë së veçantë ashtu siç e paraqiti edhe Kryetari propozoj që të thirrjmë një mbledhje të jashtzakonshme mbas 3 dite dhe e kryejmë edhe këtë.

**Rrahim Morina:** Atëherë shkojmë në votim me propozimet. Propozimi i Arbreshës ishte që kërkesat e Kryetarit të futen në rendin e ditës. Ndërsa propozimi i Alban Mazreku është që pika 3, 5,6 dhe 20 dhe 3 pikat që kanë ardhur sot të shtyhen për më tutje. Ky propozim përkrahet nga Alban Krasniqi.

**Kryetari-Ragip Bega:** Unë nuk jam pjesë e mbledhjes më, ju vazhdoni më tutje. Qeveria është e urdhuruar që vie pas meje.

**Arbreshë Krasniqi:** Pas situatës së krijuar e ftoj grupin e NISMA që ta lëshoj seancën dhe të dalim jashtë. (Grupi i NISMA e lëshon sallën)

**Rrahim Morina:** Administrata gjithësesi duhet të jetë e pranishme këtu, e ka obligim ligjor. Të pranishëm jemi 16 dhe mund të vazhdojmë mbledhjen. Atëherë të shkojmë në votim. E hedhi në votim propozimin e Albanit Mazreku është që pika 3, 5,6 dhe 20 dhe 3 pikat që kanë ardhur sot të shtyhen për më tutje. Këtë propozim e përkrah edhe LDK-ja edhe VV-ja. Kush është pro për propozimin e Albanit?

Për: 17 (unanimisht)

Propozimi i LDK-së ishte që të hyjë në rendin e ditës pika: zbatimi i udhëzimit administrativ nga gjimnazi "Hamndi Berisha" lidhur me eskurzionin e maturantëve të viti shkollor 2017/2018. Kush është për?

Për: 17 (unanimisht)

Atëherë shkojmë në votimin e rendit të ditës të ndryshuar dhe të plotësuar. Kush është për?

Për: 17 (unanimisht)

Konstatohet që është aprovuar rendi i ditës.

Kalojmë në pikën e 1-rë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. e hapi debatin.

**Nebih Bibaj:** Pershendetje kolegë asambleistë! Kam një vërejtje për fjalimin tim në seacën e kaluar sepse mu kanë hequr nja 2-3 rreshta. Është mirë me dëgju falimin në ingjizim se çka kemi folur dhe çka është shënuar.

**Rrahim Morina:** Atëherë kush është pro miratimit të procesverbalit më vërejtje?

Për: 17 (unanimisht)

Shkojmë në pushimi e drekës, kthehemi në ora 13:00.

Më vjen keq për Kryetarin Begaj, që ai po mundohet me pengu punën e Kuvendit sepse nuk janë zyrtarët e informimit këtu, ata administrativ. Këtë çështje e kam ngritur edhe në Asocasionin e Komunave, këto gjëra veç Malisheva i bënë. Zyra e Kryesuesit duhet ta ketë stafin e vet personal, leje që kjo nuk është hiç por kemi edhe një zyre të vogël 3 me 2m. Ndërsa Kryetari i ka zyret rend aty.

Kjo është përkeqardhje që i kërcnon punëtorët drejtpërsëdrejti me vend pune. Ne nuk kemi as trasmentim direkt. Kjo është hera e tretë. Jam i bindur që kjo rrugë nuk ka me çu përpara. Unë jam që të vazhdojmë mbledhjen edhe pse s'kemi trasmetim të mbledhjes. Ama nëse ju merr mendja mund edhe të mos vazhdojmë. Për këtë dua deklarimet e juaja rreth kësaj situatë.

**Alban Mazreku:** Ne jemi për të vazhduar mbledhjen.

**Valon Krasniqi:** Edhe ne grupi i LDK-së jemi për të vazhduar mbledhjen.

**Alban Krasniqi:** Sot më shumë se kurrë është e domosdoshme mos t'i nënshkrohem as pazarit e as presionit të qasjes që ka zgjedhur qeverisja Begaj duke i terrorizuar edhe punëtorët e administratës duke i kërcnuar me vendin e punës. Kjo është shkelje e rëndë ligjore. Ne si asamblesistë, për mes Kryesuesit duhet urgjentisht t'i drejtohem me një shkresë MAPL-së për t'i treguar për shkeljet që ka bërë në këtë rast Begaj me gjithë drejtorët potencialë duke tentuar që ta parandalojnë mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit të Komunës. Ne duhet gjithësesi që ta vazhdojmë këtë seancë.

Unë ka një propozim që kushdo që ka telefon të përshtatshëm le ta vendos aty live që qytetarët së paku ta shohin se çka po bëjmë përmes llogarisë private. Ne nuk mundemi me ba shkëputje mes ne nesh si anëtarë të Kuvendit dhe qytetarëve ashtu si t'potentohet të bëhet. Diktatura nuk ka birrë, në këtë rast po shihet qartë. Kriminaliteti nuk ka tjetër qasje përveç kësaj që po e shihni. Kjo është e pafalëshme!

**Rrahim Morina:** Atëherë të kalojmë në pikën e 2-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/439 datë:22.03.2018 dhe marrja e vendimit për procedurë të mëtejme për dhënien në shfrytëzim të pishinës publike në fshatin Banjë, KK-Malishevë. E hapi debatin për këtë pikë.

**Alban Mazreku:** Grupi ynë mendon që Pishina e Banjës të jepet prap në shfrytëzim sipas procedurave dhe ligjeve në fuqi. Mbase në vitin e kaluar është dhënë për shumën 15.000€. Ne mendojmë që në këtë vitit kjo pishinë të jepet me çmim për 20.000€ për shfrytëzim si dhe me pasigurimin nga kompanitë e sigurimeve.

**Alban Krasniqi:** Pishina e Banjës është njëra ndër pasuritë e pakta që i ka mbetë Malishevës në shërbim të publikut e që në 3 vitet e fundit ka filluar që t'ju jepet në shfrytëzim kompanive private. Arsyetimi ishte rritja e fitimit, të ofrimit të shërbimeve më të mira, por në fund çka kemi arritur si rezultat? Si rezultat, ne kemi një Pishinë të Banjës e cila nuk i plotëson as kushtet minimale, as higjeniko-sanitare e as të sigurisë edhe pas tri viteshe që e kanë marrur privat. Është e vërtetë që deri diku është arritur që të bie disa të hyra, mirëpo shtrohet pyetja se cili është qëllimi i një pasurie të tillë? Natyra na ka dhënë një pishinë në shërbim të qytetarit, jo në shërbim të biznesit. Pak pare komuna, shumë pare biznesi e infrastruktura e lënë në mëshirë e fatit siç është edhe tani.

Ne si grup mendojmë që duhet të diskutohet se a duhet a jo të jepet në shfrytëzim, duhet të shihet qëllimi. A është qëllimi që këtë ta gëzoj publiku i gjërë, apo është qëllimi që prej tij me nxjerrë pare?

Ne propozojmë që Pishina e Banjës t'i lihet në shfrytëzim Komunës së Malishevës me çmime të arsyeshme nga të cila çmime lirohen disa kategori që nuk kanë mundësi me pagu. Në të cilën pishinë duhet të rregullohet infrastruktura adekuate dhe të jetë në mënyrë të dinjeteshme. Të menaxhohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike ashtu siç ka qenë edhe më heret. Çmimet mos të jenë më të mëdha se sa 1€ për të rritur dhe 0.50 cent për fëmijë dhe më të vegjës se 5 vjeç hyrja të jetë pa pagesë. Nga pagesa të lirohen veteranët, familjet e dëshmorëve, invalidët, pensionistët si dhe rastet sociale që e dëshmojnë me kartelë. Mund të jetë e vërtetë që nuk i fitojnë 20,000€ komuna, mundet t'i fitojvë veç 5,000€ ode 10,000€, por me pjesën e mbetur bënë investime në rregullimin e mirëfilltë të saj që të bëhet model edhe për komunat tjera.

**Valon Krasniqi:** Ne grupi ynë e konsiderojmë të arsyeshme që Pishina e Banjës të menaxhohet nga Komuna. Mendojmë që këtë herë duhet të ketë ndryshime edhe në menaxhimin dhe efikasitetin pozitiv. Këtë herë duhet të ketë çmime më të favorshme si për të moshuarit ashtu edhe për moshat e reja. Ne e konsididerojmë që shumë primare dhe e nevojshme është që familjet e dëshmorëve, pensionistët, rastet sociale të jetë pa pagesë.

**Hashim Vrenezi:** Së pari deshta lidhem për KPF-në. Ne kemi kërkuar një raport të detajuar për të përshkruar gjendjen e pishinës, ndersa neve na ka ardh një raport shumë i mangët dhe nuk jep asnjë informatë për gjendjen reale. Thjeshtë është një përshkrim gjithëpërfshirës dhe nuk janë të specifikuara gjërat që neve na ndihmojnë për ta përcaktuar gjendjen e pishinës. Ne nuk e dimë se sa m<sup>2</sup> është pishina e madhe, sa m<sup>2</sup> është pishina e vogël, nuk është përshkruar gjendja e zhveshtoreve dhe toaleteve, megjithatë grupi i PDK-së mendon që ekonomia duhet të shkojë në vien e tregut e jo nga ekonomia e kontrolluar nga shteti. Këtë që po e them e bazoj në faktin që qeverisja Begaj në mandatin e parë që e kishte, në vitin e parë e ka pasur në menaxhim Pishinën e Banjës. Ne jemi dëshmitarë të asaj që as nuk është menaxhuar mirë, ato të hyra publike janë keqpërdorur, qytetarëve ju kanë krijuar kushte edhe më të këqija. Ne jemi shumë të vetëdishëm se çfarë institucioni kemi, çfarë mbikqyrje kemi. Shikojeni se si neve po na trajtojnë, iamgjinojeni nese ja japim hapësirën z.Begaj ta menaxhoj edhe Pishinën e Banjës me nejrëzit e vet që i ka atje, se çfarë keqpërdormie të mëdha do t'ju sjellë qytetarëve tonë dhe komunës sonë. Unë jam i sigurt që aty do të krijohet edhe ndonjë epidemi nga papastërtia, nga moskujdesi dhe nga gjithëçka tjetër. Mos të mundohemi të gjejmë pretekste që t'ja lëjmë qeverisjes Begaj ta menaxhoj Pishinën e Banjës për shkak se që në fillim e dimë që nuk ka për t'u menaxhuar mirë nga ta. Nuk ka nevojë që të gjejmë pretekst që t'i kritojmë edhe këtu, kur ka vend boll për kritika edhe tani. Unë mendoj që kjo Pishinë të jepet me ofertë sipas ligjit, të respektohet kriteli minimal

prej 20,000€ dhe data kur do t'i skadojë kontrata të jetë me një datë më të hershme jo me datë 30 qershor siç e ka tani. Ne propozojmë që data e skadimit të jetë me 28 shkurt që të ketë hapësirë që të bëhen investime atje dhe të përgatitet që të ketë të hyra sa më të mëdha.

**Alban Mazreku:** Ne mundemi që edhe në kontratë të cekim që kategoritë e dalura nga lufta të lirohen nga pagesa.

**Rrahim Morina:** Nuk e di a e kemi atë drejtë që t'ja kushtëzojmë këtë lirim nga pagesa ofertuesit. Çmimin minimal mund ta caktojmë ama pjesën tjetër ai e vendos si për çmime etj.

**Alban Krasniqi:** Me Hashimin nuk pajtohem në kuptimin e asaj që vjen prej një subjekti që nuk është e djathë radikale, është një subjekt që fillime e para i ka pas të majta. Gjithashtu vimë në një realitet aktual që bash kurgja publike nuk ka mbetë. Çdo gjë është privatizuar, veç ka mbetë edhe komunën me privatizuar. Nëse shkojmë me logjikën që nuk din komuna me menaxhuar, atëherë ne t'ja heqim përgjegjësinë komunës e t'ja japim privatit. Ai, privati, rastësisht po qëllon i njoftshëm me komunën. Ne veç po ja legalizojmë një pazar në tavolinë komunës. Unë nuk jam me legalizu një pazar të tillë. Nëse një komunë nuk është në gjendje që ta menaxhoj një pishinë, ne duhet të luftojmë ditë e natë me ndal menaxhimin e buxhetit të komunës e që janë 14,000,000€.

Ne mendojmë që kjo përgjegjësi duhet me ju dhënë komunës, sepse nuk është ai lloj aseti që duhet me ju dhanë në shfrytëzim privatit. Pishina duhet t'i plotësojë disa kushte elementare që ka të bëjë me disa kërkesa bazike të qytetarëve. Është mirë që t'i forcojmë të gjitha kriteret, por le ta merr në shfrytëzim komuna sepse është asetë i të gjithëve. Të gjitha vërejtjet që i thash mendoj që janë të qëndrueshme.

**Hashim Vrenezi:** Qëndrimi im nuk ishte pse unë i përkasë Partisë Demokratike. unë jam ekonomist dhe i mbrojtë së pari parimet e mija individuale e sigurisht edhe ato partiake, por sinqerisht nuk e di se cila kompani publike shtetërore ka treguar rezultat në menaxhimin e vet. Shetet më të forta të botës janë duke u zhvilluar për shkak të ekonomisë private, jo për shkak të ekonomisë shtetërore. Ne nuk kemi nevojë që me i tregu qytetarit që e keqpërdorë komuna sepse qytetari e din. Nëse ja lëmë në dorë komunës që me keqpërdor edhe atë pishinë, unë jam i sigurt që qytetari s'ka për të shkuar kurrë ta vizitoj atë pishinë.

**Nebih Bibaj:** Unë po besoj që komuna në çdo vend ka bërë të këqija, nuk mundem me ja lanë në shfrytëzim edhe Pishinën e Banjës sepse ku ka shkuar bërlllog e ka ba, edhe aty ashtu do ta bëjë. Unë propozoj që kjo pikë të shtyhet.

A siguroheni ju që nuk kanë me qenë të njëjtit njerëz që kanë me marrë në menaxhim Pishinën e Banjës? A mundeni me marrë përgjegjësinë që nuk janë të njëjtit njerëz? Më mirë është t'ja marrim 20,000€, e të paktën të bëjmë një harmonizim e t'i ofrojmë ndonjë kusht që të mirëmbajë pishinën nga ajo gjendje e tmerrshme. Ne këtu mund të ndahemi në pozicione, por kjo nuk është e mirë. Përsëri mendoj që është mirë të shtyhet kjo pikë.

**Rrahim Morina:** Propozimi i Nebihut është që kjo pikë të shtyhet e të bisedojmë ne tri subjektet politke për një situatë më të mirë, e mbrenda javës tjetër mund të thirim një mbledhje tjetër urgjete e vendosim për këtë çështje. A jeni që të shtyhet për një javë, kush është për?

Për: 13

Kunsër: 0

Abstenime: 4

Atëherë kjo pikë shtyhet për javën tjetër.

Kalojmë në pikën 3-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/297 datë:23.04.2018 dhe marrja e vendimit në lidhje me miratimin e bashkëpunimit ndër komunal në fushën e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë. Materialin e keni, e hapi debatin për këtë pikë.

**Alban Krasniqi:** Në bazë të shkresave ky është një lloj projekti regjional të rajonit të Ballkanit ku hynë Kroacia, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Kosova dhe Bosnja. Ka të bëjë me hartimin e planeve, projekteve që kanë të bëjnë me parandalimin e fatkeqësive natyrore. Fatkeqësi për neve është që ne e kemi marrur një material se tregon pak a shumë se si hartohet ky plan, në anën tjetër kemi marrur një draft të marrëveshjes së bashkëpunimit që është i përgjithësuar se çka synon konkretisht ky projekt. Nuk e kemi të qartë se cili do të jetë produkti i këtij projekti, ose çka synon ky lloj i bashkëpunimit. E dimë që komuat që janë të përfshira aty si Istogu, Klina, Malisheva dhe Drenasi i kanë problemet e tyre si vërshimet, rriqërat dhe vërshimet si te Malisheva, erërat e forta. Ajo çka i mungon kësaj është se me çka Malisheva ec përpara. Cilat janë ato pika që ne si Kuvend i Komunës kemi me i vendos si prioritete me i shqyrtu, a janë rriqërat, a janë vërshimet, apo janë vërshimet dhe rriqërat, apo janë edhe zjarret sepse kemi pasur raste?

Këtu mungon kryetari që e ka sjellë kërkesën, mngojnë drejtorët që kishin mundur të japin përgjigje më të plotë në këtë drejtim. Megjithatë duke e parë që është një bashkëpunim regjional, duke e parë në Kosovë janë katër komuna të ndërlidhura dhe ne në emër të një mirëbesimi në këtë drejtim duhet ta votojmë, por gjithëmonë duke e përcjellë se cilat janë rezultatet e këtij bashkëpunimi. E kam fajlën për rezultatet afatgjata dhe kush ka me ja pa hajrin kësaj pune.

**Rrahim Morina:** Dua t'ju jap një sqarim lidhur me këtë. Sot duhet të merret një vendim vetëm për nismën e këtij projekti, pra të procedohet pastaj Kryetari në bashkëpunim me kryetarët e katër kumunave dhe me MAPL-në e bëjnë marrëveshjen dhe përsi ktheht në Kuvend për votim. Edhe një herë do të votohet këtu, prandaj është mirë që sot t'ja japim vizën kësaj.

**Alban Mazreku:** Mbase në këtë pikë po kërkohet që të krijojmë parakushte ligjore, atëherë ne e mbështesim që të vazhdohet më tutje.

**Valon Krasniqi:** Po ashtu edhe grupi ynë jemi që të votohet kjo pikë.

**Nebih Bibaj:** Unë prap nuk po mundem me i kuptu se si na kanë paisur me këtë material! Dy asamblesitë materialin e kanë, shefi dhe Hashimi, ndërsa na tjerët nuk e kemi këtë material. Në të njëjtën kohe edhe sikur të ishin ata këtu ne kishim shty këtë për mungesë të materialit, por prap po ja japim dritën e gjelbër.

**Rrahim Morina:** Sipas propozimeve të tri grupeve parlamentare e hudhi në votim kërkesën: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/297 datë:23.04.2018 dhe marrja e vendimit në lidhje me miratimin e bashkëpunimit ndër komunal në fushën e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë. Kush është për?

Për: 17 (unanimisht)

Kalojmë në pikën e 4-ërt të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/404 datë: 13.03.2018, e parashtruar nga zj.Servete Krasniqi nga Malisheva, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (e përsëritur). Shefat e grupeve e kanë me gjyrë materialin, ndërsa të tjerët e kanë kopje. Aty shihet qartë që prona është mbrenda trasesë nga do të kalojë autostrada. E hapi debatin për këtë pikë.

**Alban Mazreku:** Ne në mbledhjen e kaluar e kemi shtyrë këtë pikë me arsyetim se Drejtoria e Kadastrës ka pasur të bie të kompletuar projektin e tranzitit. Mirëpo ka kaluar më shumë se 1 muaj e këtë projekt nuk e kemi. Ne jemi që me votu këtë pikë, ashtu jemi marrur vesh. Kush të dojë le të votoj ashtu si mendon.

**Alban Krasniqi:** Në fakt një shkresë ka ardhur prej Drejtorisë së Kadastrës ku e ka specifikuar në veçanti këtë pronë që thotë se kjo pronë është në kuadër të projektit për tranzitin. Ne edhe në fillim të seancës kur ishte drejtori i pranishëm i kërkoja sqarim dhe me sjellë projektin në tërësi. Kërkoja që në tërësi t'na tregoj se a është projekt-propozim, apo a është vendim qoftë i Ministrisë apo i Qeverisë që është i plotëfuqishëm dhe që ne mundemi me ec përpara me një vendimmarrje të ligjshme sa i përketë kësaj prone. Ai tha që është, kërkoja që t'na sjellë e ne të marrim vendim. Dilemën e vetme që kam është se për këtë dhe krejt parcelat që janë në shiritin e trasesë së tranzitit të cilin ne e dimë që ekziston diku por nuk po e dimë në cilat parcela. Ka apo s'ka vendim qeveritar, në këtë rast të Ministrisë. Në rast që ka vendim të Ministrisë vendimi ynë mund të jetë problematik dhe duhet me u kthi prej MAPL-së dhe ne e gjejmë vetën në një shkelje të panevojshme.

Në anën tjetër, personalisht dhe si grup jemi që të mos votohet dhe të shtyhet deri në marrjen e informacioneve edhe pse ne i kemi kërkuar ato. Ma mirë është me prit pala pak deri sa të sqarohet kjo punë se sa sot mos me mujt me i marrë votat e majftueshme mundemi me ja mohu palës një të drejtë të mundshme.

Në fund të fundit ne mund të shkojmë shefat e grupeve në Ministri dhe çfarëdo informacionesh që na japin qoftë në të shkruar, qoftë gojarisht që t'na bindin që ai është veç projekt dhe nuk ka vendim. Projektet që janë pezull neve nuk na intersojnë. Neve na intersojnë vendimet.

**Alban Mazreku:** Ne po pajtohemi ta shtyejmë, ama të jetë shtyrja e fundit kjo deri në javën tjetër kur do të merret vendimi për Pishinën e Banjës të jetë edhe kjo.

**Valon Krasniqi:** Edhe ne LDK-ja jemi që kjo pikë të shtyhet.

**Rrahim Morina:** Pika për Pishinën e Banjës edhe kjo le të mbeten për mbledhjen e jashtzakonshme. Kush është që kjo pikë të shtyhet?

Për: 17 (unanimisht)

Kalojmë në pikën e 5-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2017 (e perseritur). Në mungesë të Kryetarit nuk kemi pse ta diskutojmë këë pikë. Që tri mbledhje radhazi po shtyhet. Kush është që kjo pikë të shtyhet përëri si dhe pikat 6, 7, 8 (sipas ftesave i bie pika 8, 9, 10, 11) në mungesë të Kryetarit dhe drejtorëve komunal?

Për: 17 (unanimisht)

Kalojmë në pikën e 9-të të rendit të ditës: Emërimi i anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (e përsëritur). Materialin e keni marrë, ka vetëm një ndryshim që sot ju kemi sjellë.

Ndryshimi është se Feim Hoxha është Kryetar i Këshllit të Prindërve në nivel komune. Po i lexoj emrat një për një.

1. Halil Morina, përfaqësues i Stacionit të Policisë në Malishevë
2. Xhevat Kryeziu, përfaqësues i Bashkësisë Islame në Malishevë
3. Hidajete Mazreku, përfaqësuese e komunitetit që shkon me automatizëm
4. Vera Bytyqi, përfaqësuese e Zyrës për Barazi Gjinore
5. Blerim Thaçi, përfaqësues i DKAE-së
6. Feim Hoxha, Kryetari i Këshllit të Prindërve
7. Xhavit Kelmendi, përfaqësues i FSK-së
8. Liridona Avdijaj, përfaqësuese e Këshllit Lokal për Siguri në Bashkësi
9. Sejdi Paqarizi, përfaqësues i Ekipit për Siguri në Bashkësi
10. Valon Gashi, përfaqësues i Drejtorisë për Shpëtim dhe Mbrojtje
11. Gani Gashi, i Organizatës Joqeveritare në Komunën e Malishevës
12. Edona Krasniqi, përfaqësuese e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim
13. Feride Hoxha, përfaqësuese për personat me aftësi të kufizuara

E hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës.

**Alban Mazreku:** Ne nuk jemi për t'u lëshuar në debat për këtë pikë, vetëm kemi një propozim që të votohen një nga një këta emra të propozuar, e në fund të gjithë së bashku.

**Alban Krasniqi:** Disa prej propozimeve janë të vetëpropozuar, të vetënëshkruar dhe të ardhur këtu në mënyrë joserioze. Te përfaqësuesi i organizatave joqeveritare për Komunën e Malishevës, Kryetari i Lidhjes së Pensionistëve Gani Gashi nga Kjeva është organizata qeveritare më aktive në Malishevë, e kushtet i kanë më të vështira që mundet t'i ketë një organizatë. As internet, as kompjuter, as televizor. Me makinë shkrimi janë, kaq i kanë kushtet! Në anën tjetër i gjejmë disa përfaqësues në secilin vend, si në këtë rast HENDIKOS. HENDIKOS-i automatikisht është si organizatë që merret me personat me aftësi të kufizuara dhe e kanë marrë një person tërsisht tjetër aty që kanë tentuar me shti këtu.

Prej mediave lokale nuk e di a ka ndonjë propozim, sepse nuk s'kam hasur në ndonjë propozim. Te komuniteti i biznesit gjithaashtu nuk ka propozim sepse unë nuk kam parë ndonjë propozim. Në pajtim me atë që tha edhe Albani, e kemi diskutuar edhe në KPF këtë çështje të votohen emër për emër për këto propozime.

**Valon Krasniqi:** Ne LDK-ja pajtohemi me propozimet e Alban Mazrekut dhe Krasniqit.

**Rrahim Morina:** Ne mund t'i votojmë vetëm ata emra që jemi të sigurtë, ndërsa tjerët i lajmë për mbledhjen tjetër, kështu e jep edhe udhëzimi administrativ. Nëse edhe dikush jep dorëheqje për t'u zëvendësuar duhet të votohet përmes Kuvendit.

1. Halil Morina, përfaqësues i Stacionit të Policisë në Malishevë. Kush është për?

Për: 17 (uananimisht)

2. Xhevat Kryeziu, përfaqësues i Bashkësisë Fetare në Malishevë. Kush është për?

Për: 17 (unanimisht)

3. Hidajete Mazreku, përfaqësuese e komunitetit që shkon me automatizëm. Kush është për?

Për: 17 (unanimisht)

4. Vera Bytyqi, përfaqësuese e Zyrës për Barazi Gjinore. Kush është për?

Për: 17 (unanimisht)

6. Blerim Thaçi, përfaqësues i DKAE-së. Kush është për?

Për: 17 (unanimisht)

7. Feim Hoxha, Kryetari i Këshillit të Prindërve. Kush është për?

Për: 17 (unanimisht)

8. Xhavit Kelmendi, përfaqësues i FSK-së. Kush është për?

Për: 17 (unanimisht)

9. Liridona Avdijaj, përfaqësuese e Këshillit Lokal për Siguri në Bashkësi. Kush është për:

Për: 17 (unanimisht)

10. Sejdi Paqarizi, përfaqësues i Ekipit për Siguri në Bashkësi. Kush është për?

Për: 17 (unanimisht)

11. Valon Gashi, përfaqësues i Drejtorisë për Shpëtim dhe Mbrojtje dhe Halit Mazreku. Kush është për?

Për: 17 (unanimisht)

12. Gani Gashi, përfaqësues i Organizatës Joqeveritare në Komunën e Malishevës. Kush është për?

Për: 17 (unanimisht)

13. Edona Krasniqi, përfaqësuese e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim. Kush është për?

Për: 17 (unanimisht)

Nuk kemi përfaqësues për dy organizata. Përfaqësues për mediat lokale në K. e Malishevës që nuk votohet dhe mbetet për mbledhjen tjetër si dhe një përfaqësues i komunitetit të biznesit që nuk ka të propozuar.

16. Feride Hoxha, përfaqësuese për personat me aftësi të kufizuara. Kjo është e propozuar. Kush është për?

Për: 17 (unanimisht)

Të gjithë këta anëtarë për Komitetin i votuan me vota unanime, tani rradhën e kanë të votohen komplet. Kush është për?

Për: 17 (unanimisht)

Atëherë kostatojmë që Këshilli për Siguri në Bashkësi është votuar në përjashtim për dy vende që nuk kishte të propozuar e që mbetet t'i votojmë në mbledhjen tjetër.

Kalojmë në pikën e 10-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/481

datë:30.03.2018 për iniciimin e procedurave për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për z. Enver Kastrati nga fshati Maxharrë. E hapi debatin për këtë pikë.

**Nebih Zogaj:** Ne jemi që kjo pikë të hidhet në votim.

**Valon Krasniqi:** Pasi që kjo kërkesë kaloji nëpër KPF, mendoj që duhet të votohet.

**Alban Krasniqi:** Si për këto vendime ashtu edhe për vendimet tjera kërkoj që të krijohet një praktikë e re që këto vendime që po i marrim t'i kemi edhe ne në formë të shkruar sepse ne nuk e kemi asnjë vendim. Në veb-faqe pjesa ndërrmuese nuk është dhe ne po jemi të mohur me ditë se si është shkruar ai vendim i yni. Në bazë të udhëzimit administrativ në vendim duhet me qenë edhe shuma që obligohet të paguaj për ndërrim-destim të tokës.



**Rrahim Morina:** Ju siguroj që të gjitha vendimet që i merr Kuvendi mund t'i gjeni në zyrën time në cdo kohë. Kush është pro kësaj kërkesë për ndërrim-destinim?

Për: unanimitisht

Kalojmë në pikën tjetër që i bie e 11-ta: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/79

datë:05.04.2018, e parashtruar nga Maliq Paqarizi nga fshati Dragobil, për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. E hapi debatin për këtë pikë.

**Alban Mazreku:** Ne e kemi diskutuar edhe në grup kjo është hera e fundit që po i diskutojmë këtu kërkesat e qytetarëve në këtë mënyrë. Këto kërkesa pa e marrur një vendim të Drejtorisë së Bujqësisë, të Urbanizmit dhe asaj të Inspektoriatit ne do të votojmë kundër herave tjera.

**Rrahim Morina:** Mbase s'ka debatues të tjerë atëherë kush është pro kësaj kërkesë?

Për: unanimitisht

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/69

datë:03.04.2018, e parashtruar nga Adem Hoti nga Malisheva, për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. E hapi debatin për këtë pikë.

Mbase s'ka debatues atëherë kush është pro kësaj kërkesë?

Për: unanimitisht

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/110 datë:

18.04.2018 e parashtruar nga Zenun Krasniqi nga fshati Astrazup, për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. E hapi debatin për këtë pikë.

Atëherë kush pro kësaj kërkesë?

Për: unanimitisht

Atëherë konstatojmë që edhe kërkesa e Zenun Krasniqit për ndërrim-destinim nga toka bujqësore në tokë ndërtimore aprovohet.

Kalojmë në pikën e 14-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/97

datë:11.04.2018 e parashtruar nga shefi i grupit të anëtarëve të Kuvendit të Lëvizjes VETËVENDOSJE, për rikthimin e të drejtës së parkimit të makinave përgjatë rrugës "Rilindja Kombëtare (Ibrahim Mazreku)". E hapi debatin rreth kësaj çështje. Materialin e keni, nënshkrimet i keni, urshëroni Alban si sponsorizues i pikës!

**Alban Krasniqi:** Të gjithë ne kemi bërë përpjekje për të pasur dokument, pra vendimin që ka ndalu të drejtën e parkingut në atë rrugë por të cilin nuk kemi gjetur askund as në arkivat e komunës. Vendimi ka synuar pak a shumë të ndreqet komunikacioni, por ne krejt çka kemi parë në komunikacion ka qenë një hapësirë ku shoferet kanë vozitur më shpejt dhe ka pasur edhe aksidente si ai i rëndi kur është shkelur një këmbësor.

Të gjitha bizneset që janë përgjatë asaj rruge janë ankuar dhe kanë shprehur paknaqësitë me një kërkesë që kjo të shtyrtohet dhe të rikthehet si e drejtë. Në anën tjetër komuna ka dështuar që të vendosë shenjat e nevojshme të komunikacionit që rregullon qarkullimin e komunikacionit në tërësi. Me këtë vendim s'kanë rregulluar asgjë veç e kanë zënë trotuarin sepse shumica e makinave po parkohet aty. Nëse ne kishim me kthi të drejtën e parkingut aty me një klauzolë të qartë që ndalon parkingun në pjesën e trotuarit, me një klauzolë të qartë që kjo e drejtë e parkingut të bëhet i përkohshëm veç sa për të kryer njerëzit shërbimet e tyre. Besoj që kjo do ta kishte ndihuar edhe bizneset, por edhe qytetarët.

Zgjidha më e mirë për atë rrugë do të ishte që të bëhen rrugë alternative e ndoshta ajo rrugë në një të ardhme të kthehet në një shetitore. Kjo e kishte rrit qarkullimin e qytetarëve dhe do ta

riste mundësinë e të bërit biznes më mirë. Kjo e do një guxim politik dhe një guxim qeversje e i cili guxim shihet qartë që nuk është.

Këtu rrol të veçantë ka edhe policia. Gjatë verës nuk janë automjetet që po e bllokojnë rrugën, por është mungesa e përkujdesjes së policisë. Ata për 3 muaj të verës gjithëmonë duhet me qenë në terren duke e rregulluar trafikun. Komuna duhet me rregullu çështjen e parkingut duhet me ba me pare, e kështu të rregullohet çështja e parkingut përkohësisht.

**Nebih Bibaj:** Ne pajtohemi që të ketë ndalesë në atë pjesë të rrugës, po jo edhe parking. Ndalesë me pasë deri në 15 min gjatë ditës, e parkingu me fillu nga ora 20 deri në 7 të mëngjesit.

**Valon Krasniqi:** Ne jemi që të drejtën e qytetarëve të mos t'ju mohojmë dhe të rikthehet parkingu i makinave përgjatë kësaj rruge. Mirëpo kjo mund të jetë për një kohë afatshkurte që të shohim se si është më mirë për të ardhmen.

**Rrahim Morina:** Po flas nga foltorja dhe mendoj që është pak problematike kjo çështje. Në parim jam që të votohet rikthimi i parkingut, e sa i përketë formës është mirë të dulemi e ta diskutojmë së bashku. A rregulloget sipas orës ky parking, apo bëhet me pagesë këtë mund ta vendosim bashkarisht formën që është më e favorshme për qytetarët e Malishevës. Prandaj kërkoj që ta votojmë në parim e masandej e vendosim se si.

Mirë, atëherë mbase po kërkon ju PDK-ja shkojmë në pauzë për 5 min.

Pas pauzës, urdhëro Alban!

**Alban Krasniqi:** Pas konsultimeve ne bashkarisht u dakorduar që vendimi të themelohet që të rikthehet e drejta e parkingut përgjatë rrugës “Rilindja Kombëtare” prej orës 7:00 të mëngjesit deri në 19:00 në mbrëmje vetëm 15 min. prej orës 19:00 në mbrëmje deri në ora 7:00 të mëngjesit të kenë të drejtë parkingu të plotë. Gjithaashtu autorizohet komuna që komformë rregullave të trafikut dhe ligjive që ekzistojnë të bëjnë shenjëzimin horizontal dhe vertikal në lidhje me këtë vendim. Ky është propozimi im.

**Rrshim Morina:** Propozimi i Albanit ishte që: të rikthehet e drejta e parkingut përgjatë rrugës “Rilindja Kombëtare” prej orës 7:00 të mëngjesit deri në 19:00 në mbrëmje vetëm 15 min. ndërsa prej orës 19:00 në mbrëmje deri në ora 7:00 të mëngjesit të kenë të drejtë parkingu të plotë. Urdhërohet drejtoria përkatëse që të bëjë shenjëzimin sipas vendimit të Kuvendit Komunal në Malishevë.

**Alban Mazreku:** Kryesues, në fillim po thuhet të rikthehet e drejta e parkingut, pastaj e ndalejes. Më mirë do të ishte të thuhet të rikthehet e drejta e ndaljes deri në 15min nga ora 7:00-19:00. Ndërsa e drejta e parkingut prej orës 19:00-7:00.

**Rrahim Morina:** Lejohet ndalja për 15 min nga ora 7:00 e mëngjesit deri në ora 19:00 e mbrëmjes. Nga ora 19:00 e mbrëmjes deri në ora 7:00 e mëngjesit lejohet parkingu dhe urdhërohet drejtoria përkatëse që të bëjë shenjëzimin sipas vendimit të Kuvendit Komunal në Malishevë. Kush është për:

Për: unanimisht

Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës: Debat në lidhje me kërkesën nr.02/78 datë: 05.04.2018 të parashtruar nga Shpejtim Sertolli nga fshati Bellanicë. Materialin e keni, fjala

është për lagjen e re. Këto troje janë ndarë në vitin 2002 me vendim të Kuvendit Komunal dhe janë marrë nga 4,00€ për rregullimin e infrastrukturës të këtyre trojeve. Në atë kohë isha Kryetar i Komisionit për Ndarjen e Trojeve. Ky është një fakt që nuk është investuar asnjë centë aty. Është mirë që ato troje duhet me i pasur parasysh në të ardhmën sepse aty as nuk ka kanalizim, as ujësjellës. E hapi debatin rrethe kësaj pike.

**Nebih Bibaj:** Sa i përketë kësaj kërkesë nuk e di a është punë e Asamblesë kjo Kryesues? Së pari ky po i drejtohet Kryetarit të Komunës. Kryetari nuk po mundet me i kry punët e veta e po ja gjuan Asamblesë. Nëse nuk e marrin këta vendimin, thotë unë nuk mujta. Është mirë të sqarohet se a është punë e jona apo jo?!

**Rrahim Morina:** Realisht kjo ka qenë edhe punë e Kuvendit sepse ka mundur t'i fusë si projekte e asnjëherë nuk e ka bërë këtë. Aty s'ka pas interes të votoës prandaj ka mbetë ashtu. Paramendoni në Malishevë nuk ka kanalizim, nuk e di ku mundet me qenë justifikimi i Komunës. Gjendja aty është shumë e keqe.

**Arlind Morina:** Përshëndetje për të gjithë! Ne grupi ynë e kemi parë shqetësuese reagimin e banorëve të asaj lagjeje. Ne mendojmë që aty duhet të intervenohet sa më parë në infrastrukturën e asaj pjese. Ne e dimë që janë ndarë 1,300,000 € për rregullimin e infrastrukturës aë atyre trojeve. Gjendja aty është e mjerueshe dhe ka ardhur koha që aty të investohet. Ne e dimë që në disa fshatra po investohet nga dy herë, e aty fare. Duhet me pasë turp ata që s'janë këtu dhe të mbajnë përgjegjësi për gjendjen atje dhe anashkalimin që po i bëhet asaj pjese. Ne jemi që të shqyrtohet kjo kërkesë e tyre dhe të merret një vendim sa më i shpejt.

**Alban Krasniqi:** Kam qenë ai që kam kërkuar mirëkuptimin edhe të asambleistëve dhe anëtarëve të KPF-së që ta sjellin këtë kërkesë në Asamble për t'u diskutuar me idenë që do të jenë të pranishëm edhe qeverisja lokale dhe asambleistët e NISMA. Kjo kërkesë nuk përfaqëson vetëm kërkesën e një personi por tregon nevojën urgjente që të ketë një rikthim nga qyteza e Malishevës, e cila fatkeqësisht ka mbetë në mes katundit dhe qytetit. Nuk po mundet me bërë hapin në aspektin infrastrukturor e me dal e me ec drejtë një zone urbane e që mund t'i thuhet qytet. Nuk ka shesh, nuk ka lagje të urbanizuara, nuk ka plan urban etj.

Në vitin 2001 apo 2002 jam marrë vendimet që në zonën e Goleshtit të jepen në shfrytëzim këto troje për 40 vjet me të drejtë shfrytëzimi. Sot jemi afruar 20 vjetëve të dhënies në shfrytëzim të këtyre pronave dhe ne ende e kemi këtë zonë pa asnjë investim nga ana e Komunës. Është e vërtetë që mjetet janë marrë atëherë për infrastrukturë të kësaj lagje, e ndërsa ato janë shpenzuar për infrastrukturë në lagje tjera. Ne para sa të merremi me historiatin e kësaj çështje duhet të merremi me problemin aktual që aty e kemi. Si mund ta zgjidhim këtë problem?! Ne këtë mund ta zgjidhim duke e orientuar buxhetin me rishikim e tij që do të bëhet. Ne si grupe politike të dakordohemi që këto dy lagjeve t'ju kushtojmë një vëmendje më të madhe. Shumë më shumë se sa e kanë pasur deri tani. Nuk keni fshat se sa është kjo lagje sot.

Unë kërkoj nga ju që kur të vie rishikimi i buxhetit të fokusohemi në këto lagje dhe të dalim prej gëzhgjës së lokalizimit. Kërkesa është me vend, kurse ne duhet të zotohemi që të fillojmë t'i kthejmë sytë nga këto lagje.

**Ali Morina:** Përshëndetje për të gjithë! Kjo kërkesë përmbanë gjerat elementare që duhet me i pas një lagje. Mendoj që kjo kërkesë është në momentin e duhur sepse ne sot e shqyrtojmë këtë.

Ne nuk kemi mundësi sot që të bëjmë një zgjidhje për ta, por në rastin e rishikimit të buxhetit mund të propozojmë për projekte që janë patjetër që t'i ketë çdo shtëpi e qytetarëve. Unë do të doja të ishte këtu shefja e grupit të NISMA, sepse ajo tha se kinëse lideri i tyre e paska nxjerrë prej balte Malishevën, le ta sheh se ende disa lagje të qytezës së Malishevës nuk kanë kanalizime, rrymë, ujë.

**Rajmonda Krasniqi:** Sikur parafolësit për shqyrtimin e shqetësimit të nderuarit Shpejtim Sertolli për rregullimin e infrastrukturës kam biseduar vetë personalisht. Unë u njoha me shqetësimet e Shpejtimit në emër të familjeve që jetojnë aty, në atë pjesë të qytetit të Malishevës. Propozojë që në rishikimin e buxhetit të ndahen mjete për rregullimin e infrastrukturës në këtë lagje. Për rregullimin e infrastrukturës ndoshta në gjithë atë lagje mund të ketë arsyetime prej Kryetarit të Komunës dhe prej drejtorëve se nuk ka buxhet, kështu që të paktën t'ju ofrohet mundësia për rregullimin e infrastrukturës si kanalizimi, rryma, uji vetëm sa për ato familje, jo për gjithë atë lagje. Në këtë mënyrë është shprehur shqetësimi i Shpejtimit edhe pse ne kemi bërë kërkesën, Kryetari shpesh herë na është drejtuar se duhen shumë para për aty, duhet një investim shumë i madh dhe nuk kemi mundësi ta mbulojmë. Ne kërkojmë bile të paktën për ato familje t'ju ofrohet një mundësi shërbimi minimal vetëm atyre familjeve që jetojnë aty. Falemnderit!

**Hidajete Mazreku:** Pasi që është lagje e Malishevës, dua të shtojë diçka këtu. Ju e dinë që shumë troje këtu që janë dhënë, e dini se si janë dhënë. Janë dhënë pa plan, pa kurrfarë mbikëqyrjen e tyre se çka do të bëjnë qytetarët. Unë ju vertetoj që trojet janë ndarë sipas partive që janë ardhur në pushtet, duke u nisur nga Ura e Vogël e deri te Goleshi. As njëra nuk ka kanalizim, asnjëra nuk ka pasur asgjë. Një qytetar nëse nuk ka kanalizim, ujë, rrymë çka të flasim ne më shumë. Në shekullin e 21-të i japin troje vetëm sa për përfitime votash ose për ndonjë përfitim tjetër. Ky shqetësim i qytetarit është me vend dhe duhet t'ju bëhet zgjidhje sa më parë. Me risikimin e buxhetit duhet me deomos që këtyre qytetarëve, lagjia duhet të ketë kanalizim, ujësjellës dhe rrymë e që janë të drejta elementare të çdo qytetari. Unë jam qytetare e Malishevës dhe nuk kam mundësi ku të dal me familje, nuk ka park, një pishinë apo diçka tjetër nuk ka përveç kaffeve.

**Rrahim Morina:** Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës: Paraqitja e raportit nga Kryetari i Komunës për punësimet në Komunën e Malishevës me kontratë në vepër, sipas kërkesës së parashtruar nga Grupi i këshilltarëve të PDK-së. Fjalën fillimish e keni ju PDK-ja si parashtrued të kërkesës pastaj e hapi debatin.

**Alban Mazreku:** Ne këtë kërkesë ja kemi drejtuar Kryetarit të Komunës, drejtorit të Administratës dhe shefit të personelit. Këta asnjëri nuk janë këtu. Me kërkesën e grupit tim, kërkoj që kjo kërkesë të shtyhet për mbledhjen tjetër.

**Rrahim Morina:** Mirë, a po pajtoheni që kjo pikë me u shty për mbledhjen e rradhës? Kush është për?

Për: unanimisht

Kalojmë në pikën e 17-të të rendit të ditës: Debat publik mbi qeshtjet e barazisë gjinore në Institucionet publike të Komunës së Malishevës. E hapi debatin.

**Alban Krasniqi:** Qëllimi i këtij debati është të shohim dhe të marrim pak njoftime, një raport pak a shumë prej anës së Kryetarit dhe të drejtorëve për sa i përketë respektimit të drejtave të grave barazinë gjonre, trajtimit prej institucioneve që ofrojnë shërbime të caktuara si Qendra Sociale, Shtëpia e Shëndetit si dhe Stacioni i Policisë që kanë të bëjnë me dhunën në familje, dhunën ndaj grave etj. Kjo nuk është vetëm çështje e përfaqësimit saisor ashtu siç u tentua të formohet pika nga kolegët në fillim të kësaj seance, andaj mngesa e tyre dhe e ekzekutivit këtu na bënë që të kërkojmë që ta shtyejmë edhe këtë pikë të rendit të ditës. Nuk ka kuptim që ata të mos jenë këtu sepse ne kemi pyetje konkrete për ta, prandaj kërkoj që kjo pikë të shtyhet.

**Rrahim Morina:** Kërkesa e Alban Krasniqit ishte që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen tjetër në mungesë të ekzekutivit. Kush është për?

Për: unanimisht

Kalojmë në pikën e 18-të të rendit të ditës: Emërimi i anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve (e përsëritur). Ligji për Ndërmarrjet Publike parasheh 3 anëtarë të Komisionit. Një është nga Kryetari, e që ai nuk e ka sjellë emrin dhe dy janë nga Kuvendi. Këta të dy të Asamblesë ne mundemi sot t'i zgjedhim. E hapi debatin për këtë pikë.

**Alban Mazreku:** Për anëtar të këtij Komisioni grupi i PDK-së propozon Ali Morinën.

**Valon Krasniqi:** Ne grupi i LDK-së nuk kemi të propozuar asnjë anëtar për këtë Komision.

**Hidajete Mazreku:** Ne VV propozojmë Alban Krasniqin për Komisionin e Aksionarëve.

**Rrahim Morina:** Shkojmë në votim një nga një. Propozimi i parë ishte Ali Morina nga grupi i PDK-së. Kush është për që Ali Morina të jetë anëtar në Komisionin e Aksionarëve?

Për: unanimisht

Propozimi i dytë nga VV ishte që Alban Krasniqi të jetë anëtar në Komisionin e Aksionarëve. Kush është për?

Për: unanimisht

Me vota unanime Ali Morina dhe Alban Krasniqi janë anëtarë të Komisionit të Aksionarëve. Mbetë edhe Kryetari ta sjellë emrin dhe ky Komision të kompletohet.

Kalojmë në pikën e 19-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/211 datë: 12.02.2018, për marrjen e vendimit për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e Sallës së Sporteve në fshatin Drenoc (e përsëritur). Kjo çështje është debatuar dy-tri herë këtu, por përsëri e hapi debatin.

**Hashim Vrenezi:** Kjo pikë është duke u shtyrë herë pas here e është debatuar shumë. Ne grupi i PDK-së sa i përketë kësaj pike ne kemi arritur në përfundim që këtë fushë të sportit e meriton shkolla "Visar Krasniqi" dhe ne propozojmë që të hidhet në votim ky propozim. Deri te ky vendim kemi ardhur pasi që kemi dy procesverbale të fshatit. Njëri i mbajtur me 20.02.2018 në të cilin Kryesia e fshatit ka aprovuar me 11 vota për dhe 2 kundër që kjo sallë të ndërtohet në hapësirën e shkollës "Visar Krasniqi". Ndërsa pas ndërhyrjes së politikës e ku shihet qartë që në Malishevë gjithëçka është politizuar për interesa të ngushta të individëve dhe jo për të mirën e përgjithëshme, ne kemi pranuar edhe një procesverbal që janë nënshkruar disa persona të njëjtë që shihet qartë që janë kërcnuar dhe janë shantazhuar dhe kanë ndërruar mendimin e tyre. Bile aty thuhet që do të ketë edhe të tjerë që do ta ndërrojnë mendimin në ditët në vijim. D.m.th pritet

që ata të arrijnë se sa po munden të ushtrojnë presione dhe ndikimin e tyre politik për t'i detyruar njerëzit që të ndërrojnë mendimet e veta. Për ta përforcuar mendimin tonë është iniciativa që është bërë nga banorët lagjes së shkollës "Visar Krasniqi" e për të cilën iniciativë kemi një kërkesë në emër të fshatit, Kryetarit dhe Kryesisë e cila është e dt. 28.06.2016 e dorëzuar në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit. Po kjo Ministri me datën 12.01.2018 ka ndarë mjetet për të ndërtuar Sallën e Sportit në Drenoc. E çfarë ndodh më pas? Me datën 07.02.2018, drejtori i shkollës "Bajram Curri" paska bërë një shkresë që merr një vendim unanim nga Këshilli i Shkollës që salla të ndërtohet në vendin d.m.th në shkollën e tyre. Mendoj që ata nuk janë kompetentë për të bërë një kërkesë të tillë. Sikur ta bënin para datës së ndarjes së mjeteve do të kishte logjikën e vet, mirëpo kjo ka ndodhur pasi është ndarë grandit për sallën.

Unë propozoj që nuk kemi nevojë që të debatojmë për këtë pikë vetëm propozoj që të votohet propozimi ynë që kjo sallë të ndërtohet te shkolla "Visar Krasniqi" ose propozimi që ka sjell Kryeatri Begaj me grupin e vet politik. Krejt çka kërkohet është ndarja teknike, fizike e parcelës se ku do të ndërtohet dhe mendojmë që kushtet tjera jën në rregull.

**Valon Krasniqi:** Pse pajohemi me parafolësin, kemi shumë arsye. Një ndër arsyet është që vetë propozuesi për këtë sallë që të ndërtohet në shkollën "Bajram Curri" nuk është këtu. Kjo pikë të shtyhet që 5-6 herë mendoj që është e pamoralshme. Ne pajtohemi me propozimin e Hashimit që kjo sallë të ndërtohet në shkollën "Visar Krasniqi" ngase edhe Kryetari Begaj në start ka filluar që ta politizojë këtë çështje sepse nuk e ka treguar asnjëherë realitetin se si është ardhur deri te ky financim sepse përkrahet nga qeverisja e kaluar sa ishte Kujtim Shala mistër e më pas nga Kujtim Gashi. Asnjërin nuk e ka cekur dhe asnjërit nuk i ka dhënë merita dhe ka politizuar njëanshëm gjëja që në balotazh lideri i tyre e paska deklaruar që kjo sallë do të ndërtohet në shkollën "Bajram Curri".

Kjo sot duhet të hidhet në votim e të votohet për ndërimin në shkollën "Visar Krasniqi" sepse mbanë një emër aq të lartë sa që e meriton ta ketë këtë sallë.

**Alban Mazreku:** Kryesues t'i bashkangjtitën fjalët kërkesës së Hashimit që: të obligohet Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër që të del në terren, te shkolla "Visar Krasniqi" që të bëjë matjen dhe ndarjen fizike të parcelës ashtu siç është kërkuar nga Ministria e Kulturës për ndërtimin e Sallës së Sporteve në fshatin Drenoc.

**Alban Krasniqi:** Kjo çështje është e ndjeshme dhe nuk jam idhtar i gjuatjes andej apo këndeje të kësaj çështje sepse në fund prekën banorët aty. Tani dihet që në shkollën "Bajram Curri" hapësira është shumë e ngusht për të ndërtuar këtë sallë. Fakti tjetër është se nuk është e caktuar që kjo sallë të ndërtuar në këtë oborr shkolle. Ndërtimet të tilla më shumë i referohen vendit më të frekuentuar më shumë nga qytetarët. Problemi tjetër është që ka pasur kërkesë që të ndërtohet edhe te "Visar Krasniqi" ku hapësira është më e madhe, e në anën tjetër ne e kemi konsideruar që duhet gjetur një hapësirë alternative në mes të këtyre dy shkollave e ku mund të shfrytëzohet nga to dhe nga i tërë fshati sepse salla është e fshatit. Personalisht nuk e di a jam i gatësh që të votojë për këtë apo atë version nëse nuk na është ofruar një zgjidhje alternative pjesa afër xhamisë e që është në mes të fshatit.

E di që kjo vonesë ju kushton fshatarëve por megjiashtë kërkoj që kjo duhet të ketë një zgjidhje më koncensuale. Mos të harrojmë që shkolla "Visar Krasniqi" është në periferi të fshatit dhe nuk është që i lidh të gjitha lagjet deh dikujt i bjen shumë më larg të vie që të ushtrojë aktivitet

soprtiv aty. Mendoj që mos të jenë shkollat referenca, referencë të jetë hapësira ku mund të jetë më e përshtatshme për t'u shfrytëzuar nga fshati. Nee mbrojmë këtë tezë.

**Rrahim Morina:** Kjo me të vërtetë është çështje shumë e ndjeshme dhe kemi bërë përpjekje se sa ma mirë të dealim nga kjo situatë.

**Kastriot Berisha:** Përsëritet për të gjithë! Ne jemi që propozimi ynë të hidhet në votim dhe të votojme për te "Visar Krasniqi".

**Valon Krasniqi:** Edhe ne jemi që ky propozim të votohet.

**Rrahim Morina:** Ne kemi dy propozime. Propozimi i Kryetarit të Komunës është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/211 e dt. 12.02.2018 për marrjen e vendimit për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e Sallës së Sportit në fshatin Drenoc. Kërkesa tjetër është e grupit të PDK-së e përkrahur nga LDK-ja është që Salla e Sportit të ndërtohet në oborrin e shkollës fillore "Visar Krasniqi" në Drenoc dhe autorizohen drejtoritë përkatëse që t'i kryejn shëbimet që të bëjnë ndarjen dhe shenjëzimin sipas projektit që ka sjellë Ministria.

Së pari e hudhi në votim propozimin e Kryetarit edhe pse nuk është këtu. Kush është pro kërkesës së Kryetarit që e lexova pak më heret?

Për: 0

Kundër: 13

Abstenim: 4

Me këtë votim nuk kalon kërkesa e Kryetarit të Komunës.

Propozimi i dytë është i PDK-së. Kush është për që Salla të ndërtohet në oborrin e shkollës "Visar Krasniqi" në Drenoc?

Për: 14

Kundër: 0

Abstenime: 3

Me këtë votim konstatojmë që Salla e Sportit do të ndërtohet në oborrin e shkollës fillore "Visar Krasniqi" në Drenoc.

Kalojmë në pikën e rendit të ditës: Të ndryshme. E hapi debatin. Mbase s'ka debat për këtë pikë, ju falemnderoj për pjesëmarrjen dhe mbledhjen e shpalli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora 15:40

Procesmbajtësja: Samir Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit: Rrahim Morina

